

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Eagle24” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 21.12.2023, ne të poshtëshënuarit;

Elson Kanavace, i datëlindjes 27.07.1985, lindur ne Berat dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I50727004R.

Nazmi Kurti,i datëlindjes 13.03.1987, lindur ne Bastar,Tirane dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I70313132R.

Isan Krasniqi i datëlindjes 04.02.1991, lindur ne Orçikël Kukës dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti,me numër personal ,J10204110D.

Me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Eagle24**” shpk.

Neni 1. Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin“**Eagle24**” shpk, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria “**Eagle24**” shpk e ka seline në adresë: ”Teodor Keko”,Rezidenca Future Home,Kulla nr 2,Kati i 1, Ap C1A5, njesia bashkiake nr 6,Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine “**Eagle24**” shpk është:Investime ne pasurite e patundshme,import dhe eksport mallrash,menaxhim fondesh per te trete,agjensi punesimi brenda dhe jashte vendit.Aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme.Aktivitet në fushën e pasurive

të patundshme, vlerësim i pasurive të patundshme. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objekteve të tjera. Administrim i bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Dhënie me qera dhe nënqera të ambienteve të ndryshme. Guida turistike.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota të cilat zotërohet si më poshtë:

Elson Kanavace, i datëlindjes 27.07.1985, lindur ne Berat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,I50727004R, zotëron një kuotë ose 33,33 % të shoqërisë.

Nazmi Kurti, i datëlindjes 13.03.1987, lindur ne Bastar, Tirane dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,I70313132R, zotëron një kuotë ose 33,33 % të shoqërisë.

Isan Krasniqi i datëlindjes 04.02.1991, lindur ne Orçikël Kukës dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,J10204110D, zotëron një kuotë ose 33,34 % të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë , pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.




Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për



detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë “**Eagle24**” shpk është: Elson Kanavace, i datëlindjes 27.07.1985, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal ,I50727004R.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 21.12.2023.
Afati i emërimit të administratorit është deri me 21.12.2028.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.


Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare **"Eagle24" shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES


Elson Kanavace



Nazmi Kurti



Isan Krasniqi



Tiranë, më datë 21.12.2023